



01 Nr. 714/24 Dt. 20.11.2024



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, kryetari i Komunës, merr këtë:

### V E N D I M

#### Për lejimin e punimeve shtesë dhe mjeteve shtesë

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, konform kërkesës së Operatorit Ekonomik (kompania punë kryerëse) dhe kërkesës (raportit) të Organit Mbikëqyrës, për lejimin (aprovimin) e punimeve shtesë (të paparashikuara) dhe mjeteve financiare shtesë në realizimin e projektit: “Ndërtimi i infrastrukturës (rrugët dhe ambientit) turizmit malor dhe rural-Nashec” projekt dy vjeçar, kështu që, për realizimin e tërësishëm të këtij projekti, lejohen (aprovohen) punimet shtesë dhe mjetet financiare shtesë në shumë prej 22.40,00 € (njëzetë e dymijë e katërdhjetë euro).
2. Pagesa e shumës së lejuar nga pika 1 e këtij Vendimi do t’i bëhet përfituesit të kontratës së punës nr. prok. 622-23-1980-5-2-1.
3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, nr. 53438.
4. Obligohet Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik, Sektori i Prokurimit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës  
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik,
  - Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
  - Sektorit të Prokurimit,
  - Arkivës së Kryetarit.

